




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.16, datë 08.05.2023



PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “ERGI-PINK” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhimhidroenergjetik shoqërisë “Ergi-Pink”, sipas Kontratës me Nr. 1485 Rep., Nr. 1930 Rep., Nr. 1094/1 Kol., datë 31.08.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin hidrocentralit “Liseci”, me kapacitet prodhues 1,570 MW në pellgun ujëmbledhës të përroit të Gjemthit dhe përroit të Madh, degë e lumit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Liseci

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor Përroi i Gjemthit



- X= 529490; Y= 4531956; Z=1000 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.56 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.41 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.28 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.028 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2/ burimi ujqor Përroi i Madh

- X= 527986; Y= 4531374; Z=1010 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.16 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.12 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.1 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.007 m³/s

Vendndodhja e godinës së centralit

- X= 528796; Y= 4533025; Z=730 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.72 m³/s
- Prurja për bujqësinë: 0.03 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 6.021.866 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 1570 kwh
- Vlera totale e investimit: 295,835,290 lekë.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH), ku kanali i largimit të godinës së HEC-it Liseci takon trupin ujqor pritës.

- X= 528757.19; Y= 4533044.16; Z=725 m.m.n.d. (KRGJSH).

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

